

# STATUT I SHOQERISE " KEDO GROUP " SHPK

Në Tiranë, sot më datën 17/ 12 / 2020 (Dymijë e njëzet), ne seline e shoqerise Ortaket:

1. **Znj. Enkeleda HYSENBELLI**, atesia Veip, e datëlindjes 30.09.1971, lindur dhe banuese në Tirane, Nesia Administrative Nr.9, madhore me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me ane te Letërnjosfimit me numër personal H15930078J;
2. **Z. Kevin HYSENBELLI**, atesia Kasëm, i datëlindjes 07.03.1994 lindur dhe banues në Tirane, Nesia Administrative Nr.9, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me ane te Letërnjosfimit me numër personal J40307058S;
3. **Znj. Donika HYSENBELLI**, atesia Kasëm, e datëlindjes 08.07.1996, lindur dhe banuese në Tirane, Nesia Administrative Nr.9, madhore me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me ane te Letërnjosfimit me numër personal J65708072N;

me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 date 14.04.2008. "Për shoqëritë tregtare", në ligjin " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, hartojmë kete statut per shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin: "**KEDO GROUP**" Sh.p.k më poshtë e quajtur "Shoqëria".

## KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "**KEDO GROUP**" Sh.p.k, është person juridik i së drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria"), emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.-

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

Shoqëria "**KEDO GROUP**" Sh.p.k, është një e tillë, kapitali i se cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket themelues që përballojnë humbje vetëm deri në kuqirin e vlerës se kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në Tirane, Rruga "Elbasanit", Vila 5/78, Prane Fakultetit Ekonomik, Njesia Bashkiake Nr.2.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, te hapë degë jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të asamblese se përgjithshme.

Shoqëria mund të hapë, mbyllë adresë dytesore, brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të administratorit.

Neni 4  
Objekti i veprimitarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë:

"Aktivitet ne fushen e mediave elektronike dhe te shkruara, botime te ndryshme, prodhim e publikim reklamash, tregtim paisjesh per nevojat e mediave elektronike. Ndermjetesim per blerje shitje dhe dherie me qira te pasurive te paluajtshme. Shitja, blerja, dhenia me qira e pasurive te lujtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar financiar qiradhenes apo dorezenes qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme qe sjellin perfitim ekonomik. Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie ekonomike qe lejohet nga legjislacioni shqiptar".

Shoqëria ka të drejtë të shtojë objektin e veprimtarisë së saj, në çdo kohë sipas ligjeve në fuqi.

### Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100.000 (njeqind mijë Leke)** dhe është i ndarë në 3 Kuota. Secili ortak zoteron një kuote e cila përfaqeson vlerën totale te kontributit të derdhur prej tij në kapitalin e shoqërisë. Kapitali i shoqërisë zoterohet nga:

- **Znj. Enkeleda Veip HYSENBELLI**, zoteron 1 (një) kuotë me vlerë te përgjithshme **33,333.33** Leke, që përbijnë 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Kevin Kasëm HYSENBELLI**, zoteron 1 (një) kuotë me vlerë te përgjithshme **33,333.33** Leke, që përbijnë 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Znj. Donika Kasëm HYSENBELLI**, zoteron 1 (një) kuotë me vlerë te përgjithshme **33,333.33** Leke, që përbijnë 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime. Ortaket themelues përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë; Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta). Ortakët e shoqërise i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëritjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të artihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporit i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Biznesit së bashku me të dhënat e tjera të kërkura për regjistrim.

#### Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit cve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të asamblesë se per gjithshme në të njëjtat kushte që kërkoen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpala datës së mbledhjes së asamblesë se per gjithshme të thirrur për të marrë vendim treth këtij projektin.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuara në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjeter. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

### **Neni 8** Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e asamblesë se per gjithshme.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimic. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nëpërmjet akteve ligjore.


## **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 9** Organë Vendimmarrës

**1. Asambleja e Përgjithshme** është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve dhe te Drejtoreve te Përgjithshem;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmaçhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përsaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**2. Asambleja e përgjithshme** merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij nenit, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.



**3.** Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë se përgjithshme ushtrohen nga ortaket e shoqerise. Të gjitha vendimet e marra nga asambleja se përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në vëçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet përiorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjiistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëhesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i trcti ka pasur dijcmi për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrithanave të qarta nuk mund t'ë mos kishte pasur dijcmi për të.

**4.** Ortaket mund të përfaqësohen edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

**5.** Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

#### **Neni 10** **Kuorumi**

**1.** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund t'ë marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund t'ë marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë.

**2.** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund t'ë mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**

**1.** Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës ku prezent duhet të jane ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, për ndryshimin e statutit, zmadhimin osc zvogçlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**2.** Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji.

**3.** Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### **Neni 12** **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit vendosen nga asambleja e përgjithshme.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 13**  
**Administrimi**

Administratori emërohet që shkarkohet me vëndim të asamblesë se Pergjithshme të shoqërisë. Asambleja e Pergjithshme vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat. Administratori/rët mund të jenë ose jo ortakë të shoqërisë. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administrator i shoqërisë është **Znj. Donika Kasëm HYSENBELLI**

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e tij në ketë detyre për një periudhe **5 vjeçare**.

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorit**

Shoqëria administrohet nga një Administrator.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) rrijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- c) raportoj përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- d) Administratori përsaqëson shoqérinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.
- e) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
- f) nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar
- g) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- h) Administratori angazhon shoqérinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përpunhje me objektin e saj.
- i) Administratori ka të drejtë të nënshkruaj kontrata të ndryshme me furnitore, kliente, kontrata qiraje, pavec kontrata shit/blerje asetesh, pasurish te patundshme, kontratave kredish bankare apo nga të trete dhe hipotekime të pasurive të tundshme apo to patundshme te shoqerise, per te cilat duhet te merret vendim i Asamblese se Ortakeve.
- j) Administratori ka të drejte të nënshkruaj e hartoj çdo dokument e të kryeje në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive tijedhëse të Shoqërisë, si dhe të kryej veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.
- k) Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

- l) Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të trejtë.
- m) Administratorit osc ortakut që nuk është person juridik, nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qofshë, të marrin hua te shoqëria, të jalin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënë apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

### **Neni 15** **Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja e per gjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individual pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket kane të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Ortaket kane të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbllimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaket që nuk janë administrator, kane të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

### **Neni 16** **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Përjashtimisht viti i parë- finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mballet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17** **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e asamblesë se per gjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mblodhja e asamblesë se per gjithshme vendos rrëth shpërndarjes së dividendifit, pasi të jenë zbritur humbjet e viti të mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 18** **Ekspertët**

Ekspertri ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë se per gjithshme.

Në përfundim të kontrollit ekspertri kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe për atë për kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t' ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t' i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **Neni 19**

#### **Bilanci**

Bilanci Kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga asambleja e pergjithshme i cili jo vëtëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondevve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhc garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçante etj.

### **Neni 20**

#### **Dividendi**

Të ardhurat neto ( Dividendi ) që mbeten pas veçimit të fondevve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhc i kalojnë në pronësi ortakeve të shoqërisë.

### **Neni 21**

#### **Shpërndarja ose prishja e shoqërisë**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit osc paftundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj;
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqërite Tregtare"
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Ne ketë rast asambleja e pergjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

### **Neni 22**

#### **Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese osc një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërise të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja. Asambleja e pergjithshme e shoqërisë, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura më lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna. Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërise të formave të ndryshme. Bashkimi osc ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi osc ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërise që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërise përfituese sipas kushteve të përcakuara në kontratën e bashkimit osc ndarjes.

### **Neni 23**

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhc dokumentet që duhen depozituuar në Aneksin e Regjistrit Tregtar.

#### **Neni 24**

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditor dhe për ekzekutimin e detyrimeve, dëbive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

**Neni 25**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në ketë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.


**Neni 26**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 27**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u hartua ne 4 ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaket e shoqërisë tregtare "**KEDO GROUP**" Sh.p.k, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

**ORTAKET E SHOQERISE**

1. Donika Hysenbelli 
2. Kevin Hysenbelli 
3. Cukelola Hysenbelli 